



**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE  
PER OBJEKTIN E SHFRYTEZIMIT ME  
KARRIERE TE MINERALIT TE RANORIT  
PLLAKOR, NE ZONEN MINERARE NR.428,  
OBJEKTI "SINJE", BASHKIA SKRAPAR,  
QARKU BERAT.**



**PER SHOQERINE "PE&SA" SH.P.K, BASHKIA SKRAPAR**



Studimi gjeologjor mineral dhe projekti tekniko ekonomik i shfrytëzimit të gurëve ranore pllakore në objektin “Mollas”, Skrapar, që ben pjesë në komunën Qender, të rrethit Skrapar, Qarku Berat, është kryer me porosi të shoqërisë private “PE&SA shpk”, regjistruar në QKB Tiranë, me administratorin zotin **Sazan Lamçe** dhe me seli në Skrapar, Lagjia “Hasan Seitaj”, rruga “Arkitekt Kasemi”, godine 1- kateshe, Çorovode

Nëpërmjet tij synohet të shfrytëzohen ranoret pllakore sipas ligjit Nr.10304, datë 15/07/2010 “Per Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nenligjore të dalës në zberthim dhe për zbatim të tij, klasifikohen në grupin e mineralve ndërtimore..

Shfrytëzimi do të bëhet me kariere nga shoqëria Shoqëria “PE&SA shpk”. Zona e kerkuar ka një sipërfaqe prej 0.07 km<sup>2</sup> dhe përfshihet midis kuotave +840m deri në +940m.

## **I.-2 Vendndodhja e objektit**

Vendburimi i ranoreve pllakore dekorativ kerkuar për shfrytëzim nga subjekti “PE&SA” shpk, ndodhet në të djathtë të rrugës automobilistike Çorovode -Radesh në afërsi të fshatit Mollas, të njësive administrative Qender, të bashkisë së Skraparit. Kjo zonë është një zonë kodrinore me lartësi +500m deri +1000m, objekti ndodhet larg shtepëve të banimit, objekteve social kulturore etj.

Objekti i ranoreve për të cilin hartohet studimi ndodhet në territorin e fshatit Mollas, të bashkisë Skrapar në të majtë të rrugës Çorovode -Radesh, në Jug Perëndim të Vendburimit ndodhet fshati Verzbeza rreth 1 km larg në vijë ajrore, ndërsa në veri perëndim ndodhet fshati Dobrushe.

Në Jug të zonës në studim ndodhet qyteti i Çorovodës, rreth 4km.

Në jug dhe në jug -lindje të zonës kalon lumi i Osumit i cili ndodhet rreth 3-4 km larg tij . Administrativisht i përket ndarjes administrative të Bashkisë Skrapar.

Qendra administrative rurale e zonës në fjalë është Njësia Administrative Qender. Skrapar. Rreth e rrotull objektit nuk ndodhen shtëpi banimi, objekte social-kulturore, shkolla, depo etj. Rrugët në rajon që lidhin objektin me qendrat e banuara janë përgjithësisht të pa asfaltuar dhe kërkojnë riparime të pjesëshme .

Konturet e objektit paraqiten në hartën topografike të nomenklaturës K-34-125-A-d Çorovodeqe i bashkëngjitet studimit.

n/Pikes	Y	X
1	4434225	4489865
2	4434450	4489925

3	4434250	4489410
4	4434225	4489500
5	4434240	4489625
6	4434160	4489660
7	4434150	4489840

Tabela Nr 1 Koordinatat e zones e shfrytezimit

Siperfaqja e zones qe kerkohet per leje shfrytezimi eshte 0.072km<sup>2</sup>

**Ne kete objekt nuk do te perdoren lende plasese.**